

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Menaxhmenti
strategjik i biznesit**

P12

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Shënim: Emrat e individëve, vendeve dhe kompanive, të përdorura në këtë provim janë fiktive. Çdo ngjashmëri është plotësisht e rastësishme

Data 11/07/2026

Problemi 1

RASTI

KosEnergy Infrastructure Group Sh.A.

KosEnergy Infrastructure Group Sh.A. është një kompani kosovare e themeluar në vitin 1999, e cila është shndërruar nga një biznes familjar në një nga prodhuesit më të mëdhenj rajonalë të pajisjeve për sektorin energjetik.

Veprimtaria kryesore e kompanisë përfshin projektimin, prodhimin dhe instalimin e:

- transformatorëve elektrikë;
- nënstacioneve të tensionit të mesëm dhe të lartë;
- pajisjeve për rrjetet e transmisionit dhe distribucionit;
- konstruksioneve metalike për industrinë energjetike;
- sistemeve fotovoltaike;
- sistemeve industriale të baterive për ruajtjen e energjisë.

Aktualisht kompania operon tre fabrika në Kosovë dhe një fabrikë të sapoblerë në Shqipëri. Numri i të punësuarve ka arritur në rreth 620, ndërsa të hyrat vjetore kanë tejkaluar 115 milionë euro. Produktet eksportohen në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Kroaci, Bosnje dhe Hercegovinë, Gjermani dhe Austri.

Gjatë viteve të fundit kompania ka përfituar nga investimet e konsiderueshme në infrastrukturën energjetike të rajonit dhe nga rritja e kërkesës për projekte të energjisë së ripërtëritshme. Si rezultat, të hyrat janë rritur mesatarisht 18% në vit, ndërsa fitimi operativ ka shënuar rritje të vazhdueshme.

Në mbledhjen e fundit të Kuvendit të Aksionarëve është aprovuar strategjia "**Vision 2030**", e cila parasheh:

- listimin e kompanisë në bursë brenda tre viteve;
- zgjerimin e aktivitetit në tregjet e Bashkimit Evropian;
- transformimin digjital të proceseve prodhuese;
- integrimin e inteligjencës artificiale në planifikimin e prodhimit dhe mirëmbajtjes;

- arrijen e objektivave ESG dhe neutralitetit klimatik deri në vitin 2040.

Për realizimin e kësaj strategjie kompania është në negociata me BERZH dhe IFC për sigurimin e financimit afatgjatë.

Megjithatë, raporti i fundit i auditimit të brendshëm ka identifikuar një numër çështjesh të rëndësishme të cilat mund të ndikojnë në realizimin e objektivave strategjike.

Qeverisja korporative

- Drejtori Ekzekutiv (CEO) është njëkohësisht edhe Kryesues i Bordit të Drejtorëve.
- Tre nga shtatë anëtarët e bordit janë anëtarë të familjes themeluese.
- Komiteti i Auditimit përbëhet nga dy drejtorë ekzekutivë dhe vetëm një anëtar jo-ekzekutiv.
- Nuk ekziston Komitet i Menaxhimit të Rrezikut.
- Nuk është themeluar Komiteti për ESG dhe Qëndrueshmëri.
- Politika e shpërblimit të menaxhmentit është e lidhur vetëm me rritjen e të hyrave dhe EBITDA, pa indikatorë të performancës afatgjatë.

Kontrolli i brendshëm

- Auditimi i Brendshëm raporton administrativisht dhe funksionalisht tek CFO.
- Nuk ekziston një Enterprise Risk Register.
- Nuk janë përcaktuar nivelet e Risk Appetite dhe Risk Tolerance.
- Rreziqet kibernetike nuk raportohen në Bord.
- Sistemi ERP është implementuar vetëm pjesërisht.
- Fabrika në Shqipëri përdor një sistem tjetër informatik dhe nuk është e integruar me sistemin qendror.

ESG dhe Qëndrueshmëria

Një klient strategjik gjerman ka kërkuar që kompania të raportojë sipas European Sustainability Reporting Standards (ESRS).

BERZH dhe IFC kanë kërkuar:

- plan të dekarbonizimit;

- politika për zinxhirin e furnizimit;
- raportim ESG;
- analiza të rreziqeve klimatike.

Një organizatë ndërkombëtare joqeveritare ka kritikuar kompaninë për mungesë transparence lidhur me furnitorët aziatikë dhe mungesën e politikave të Due Diligence.

Burimet Njerëzore

- Kompanisë i mungojnë rreth 70 inxhinierë elektrikë dhe mekanikë.
- Fluktuacioni i stafit është rritur në 19%.
- Nuk ekziston një program formal për Succession Planning.
- Trajnimet zhvillohen në mënyrë jo të strukturuar.

Strategjia

Bordi po shqyrton tre alternativa strategjike:

Alternativa A

Ndërtimin e një fabrike të re në Kosovë.

Alternativa B

Blerjen e një prodhuesi rajonal në Kroaci.

Alternativa C

Krijimin e një partneriteti strategjik me një kompani gjermane për transferim teknologjie dhe hyrje në tregjet e Bashkimit Evropian.

Kërkohet

1. Duke përdorur **Teorinë e Agjentit (Agency Theory)** dhe **Teorinë e Stakeholderëve**, analizoni strukturën aktuale të qeverisjes korporative të KosEnergy Infrastructure Group dhe diskutoni rreziqet që burojnë nga ndarja jo e qartë ndërmjet pronësisë dhe menaxhimit. **(8 pikë)**

2. Analizoni në çfarë mase struktura aktuale e kompanisë përputhet me parimet e:

- OECD Principles of Corporate Governance;

- UK Corporate Governance Code.

Identifikoni dobësitë kryesore. **(6 pikë)**

3. Duke u bazuar në praktikat ndërkombëtare të qeverisjes korporative, rekomandoni pesë masa konkrete që Bordi duhet të ndërmarrë për të përmirësuar qeverisjen dhe për ta përgatitur kompaninë për listim në bursë. **(6 pikë)**

Totali: 20 pikë

Zgjidhja e problemit 1

1. Duke përdorur Teorinë e Agjentit (Agency Theory) dhe Teorinë e Stakeholderëve, analizoni strukturën aktuale të qeverisjes korporative të KosEnergy Infrastructure Group dhe diskutoni rreziqet që burojnë nga ndarja jo e qartë ndërmjet pronësisë dhe menaxhimit. (8 pikë)

Teoria e Agjentit (Agency Theory)

Teoria e Agjentit shpjegon marrëdhënien ndërmjet pronarëve të kompanisë (principalët) dhe menaxhmentit (agjentët). Pronarët delegojnë autoritetin tek menaxhmenti për të drejtuar kompaninë në interes të tyre. Megjithatë, për shkak të ndarjes së pronësisë nga menaxhimi, mund të lindin konflikte interesi, pasi menaxhmenti mund të ndjekë objektivat personale në vend të maksimizimit të vlerës për aksionarët.

Në raste të tilla krijohen kostot e agjencisë, të cilat përfshijnë kostot e monitorimit, kostot e harmonizimit të interesave dhe humbjen e mbetur (residual loss).

Aplikimi në rastin e KosEnergy Infrastructure Group

Në rastin e KosEnergy Infrastructure Group evidentohen disa dobësi që rrisin problemet e agjencisë.

Së pari, Drejtori Ekzekutiv (CEO) është njëkohësisht edhe Kryesues i Bordit. Ky kombinim i funksioneve eliminon ndarjen ndërmjet rolit ekzekutiv dhe funksionit mbikëqyrës. Bordi humbet pavarësinë e tij dhe zvogëlohet aftësia për të mbikëqyrur objektivisht punën e CEO-së.

Së dyti, tre nga shtatë anëtarët e Bordit janë pjesëtarë të familjes themeluese. Kjo mund të ndikojë në objektivitetin e vendimmarrjes dhe të krijojë konflikte interesi ndërmjet aksionarëve shumicë dhe aksionarëve të vegjël, veçanërisht nëse kompania synon listimin në bursë.

Së treti, Komiteti i Auditimit përbëhet nga dy drejtorë ekzekutivë dhe vetëm një anëtar jo-ekzekutiv. Kjo bie ndesh me praktikën e mira të qeverisjes, pasi komiteti duhet të dominohet nga anëtarë të pavarur që të garantohet mbikëqyrje efektive e raportimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Së katërti, politika e shpërblimit të menaxhmentit lidhet vetëm me rritjen e të hyrave dhe EBITDA. Një sistem i tillë mund të nxisë menaxhmentin të fokusohet në rezultate afatshkurtra duke neglizhuar investimet strategjike, menaxhimin e rrezikut dhe objektivat ESG.

Rreziqet që burojnë nga problemet e agjencisë

Dobësitë e mësipërme krijojnë disa rreziqe të rëndësishme:

- vendimmarrje jo objektive dhe dominim i Bordit nga menaxhmenti;
- kontroll i pamjaftueshëm mbi raportimin financiar;
- rrezik më i lartë i mashtrimeve dhe keqpërdorimit të autoritetit;
- ulje e besimit të investitorëve institucionalë;
- vështirësi në sigurimin e financimit nga BERZH, IFC dhe investitorët potencialë gjatë procesit të listimit në bursë.

Teoria e Stakeholderëve (Stakeholder Theory)

Teoria e Stakeholderëve argumenton se kompania nuk duhet të krijojë vlerë vetëm për aksionarët, por duhet të marrë në konsideratë interesat e të gjitha palëve të interesit që ndikojnë ose ndikohen nga aktiviteti i saj.

Palët kryesore të interesit në këtë rast janë:

- aksionarët;
- punonjësit;
- klientët;
- furnitorët;
- bankat dhe institucionet financiare;
- BERZH dhe IFC;
- komuniteti;
- autoritetet rregullatore;
- organizatat mjedisore;
- partnerët ndërkombëtarë.

Aplikimi në rast

Në rastin e KosEnergy Infrastructure Group vërehen disa mangësi në menaxhimin e stakeholderëve.

Klienti strategjik gjerman kërkon raportim sipas ESRS, ndërsa BERZH dhe IFC kërkojnë politika ESG dhe analiza të rrezikut klimatik. Kompania aktualisht nuk ka Komitet ESG dhe nuk ka politika të zhvilluara të qëndrueshmërisë, gjë që rrezikon marrëdhëniet me këta stakeholderë.

Po ashtu, mungesa e transparencës ndaj furnitorëve aziatikë dhe kritikët e organizatës ndërkombëtare lidhur me Due Diligence mund të dëmtojnë reputacionin e kompanisë dhe të kufizojnë hyrjen në tregjet e Bashkimit Evropian.

Nga ana tjetër, mungesa e rreth 70 inxhinierëve dhe fluktuacioni prej 19% tregojnë se kompania nuk po menaxhon në mënyrë efektive interesat e punonjësve si një grup i rëndësishëm stakeholderësh.

Përfundim

Nga analiza sipas Teorisë së Agjentit dhe Teorisë së Stakeholderëve rezulton se struktura aktuale e qeverisjes së KosEnergy Infrastructure Group paraqet dobësi të konsiderueshme në pavarësinë e Bordit, mbikëqyrjen e menaxhmentit dhe menaxhimin e palëve të interesit. Këto dobësi rrisin rrezikun strategjik, reputacional dhe financiar të kompanisë dhe mund të pengojnë realizimin e objektivave të strategjisë "Vision 2030" dhe procesin e listimit në bursë.

2. Analizoni në çfarë mase struktura aktuale e kompanisë përputhet me parimet e OECD Principles of Corporate Governance dhe UK Corporate Governance Code. Identifikoni dobësitë kryesore. (6 pikë)

OECD Principles of Corporate Governance

Parimet e OECD-së synojnë të sigurojnë një sistem efektiv të qeverisjes korporative përmes mbrojtjes së aksionarëve, trajtimit të barabartë të tyre, transparencës, llogaridhënies dhe rolit efektiv të Bordit.

Në rastin e KosEnergy Infrastructure Group evidentohen këto mangësi:

- kombinimi i funksionit të CEO-së me atë të Kryesuesit të Bordit cenon pavarësinë e Bordit;
- përfaqësimi i konsiderueshëm i familjes themeluese mund të ndikojë negativisht në trajtimin e barabartë të aksionarëve;
- mungesa e Komitetit të Menaxhimit të Rrezikut dhe Komitetit ESG kufizon mbikëqyrjen strategjike;
- mungesa e transparencës në raportimin ESG bie ndesh me kërkesat e investitorëve ndërkombëtarë dhe të institucioneve financiare.

UK Corporate Governance Code

Kodi Britanik i Qeverisjes Korporative bazohet në parimet e lidërshiptit efektiv, ndarjes së përgjegjësisë, përbërjes së pavarur të Bordit, kontrollit të brendshëm, menaxhimit të rrezikut dhe remunerimit të drejtuesve.

Në rastin konkret:

- nuk respektohet ndarja ndërmjet Kryesuesit të Bordit dhe CEO-së;
- Komiteti i Auditimit nuk përbëhet kryesisht nga drejtorë jo-ekzekutivë të pavarur;
- nuk ekziston Komiteti i Riskut;
- sistemi i shpërblimit fokusohet vetëm në performancën financiare afatshkurtër dhe nuk lidhet me objektivat strategjike, menaxhimin e rrezikut dhe ESG;
- Auditimi i Brendshëm nuk raporton te Komiteti i Auditimit, duke dobësuar pavarësinë e funksionit të auditimit.

Dobësitë kryesore

Dobësitë më të rëndësishme të strukturës aktuale janë:

- mungesa e ndarjes së funksioneve ndërmjet CEO-së dhe Kryesuesit të Bordit;
- mungesa e pavarësisë së Bordit dhe Komitetit të Auditimit;
- mungesa e strukturave formale për menaxhimin e rrezikut dhe ESG;
- sistem shpërblimi i orientuar vetëm drejt rezultateve financiare afatshkurtra;
- kontroll i dobët mbi auditimin e brendshëm dhe raportimin e rrezikut.

Në përgjithësi, kompania përmbush vetëm pjesërisht kërkesat e OECD Principles dhe UK Corporate Governance Code dhe do të duhet të ndërmarrë reforma të rëndësishme para se të konsiderohet e gatshme për listim në bursë.

3. Duke u bazuar në praktikat ndërkombëtare të qeverisjes korporative, rekomandoni pesë masa konkrete që Bordi duhet të ndërmarrë për të përmirësuar qeverisjen dhe për ta përgatitur kompaninë për listim në bursë. (6 pikë)

Për ta përgatitur kompaninë për listim në bursë dhe për të përmbushur kërkesat e investitorëve institucionalë, BERZH-it dhe IFC-së, Bordi duhet të ndërmarrë këto masa:

1. Ndarja e funksioneve të CEO-së dhe Kryesuesit të Bordit

Roli i Drejtorit Ekzekutiv duhet të ndahet nga ai i Kryesuesit të Bordit për të garantuar mbikëqyrje të pavarur dhe për të shmangur përqendrimin e autoritetit në një person të vetëm.

2. Rritja e pavarësisë së Bordit dhe e komiteteve

Duhet të emërohen më shumë drejtorë jo-ekzekutivë të pavarur dhe Komiteti i Auditimit duhet të përbëhet kryesisht nga anëtarë të pavarur me ekspertizë financiare. Gjithashtu duhet të krijohen Komiteti i Riskut dhe Komiteti ESG.

3. Përmirësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të rrezikut

Kompania duhet të krijojë një Enterprise Risk Register, të përcaktojë Risk Appetite dhe Risk Tolerance dhe të sigurojë që Auditimi i Brendshëm të raportojë funksionalisht te Komiteti i Auditimit.

4. Përmirësimi i sistemit të remunerimit

Politika e shpërblimit duhet të lidhet jo vetëm me EBITDA dhe të hyrat, por edhe me objektivat afatgjata, menaxhimin e rrezikut, performancën ESG, inovacionin dhe krijimin e vlerës për aksionarët.

5. Rritja e transparencës dhe raportimit

Duhet të zhvillohet raportim i plotë financiar dhe jo-financiar sipas standardeve ndërkombëtare, duke përfshirë raportimin ESG, analizat e rrezikut klimatik, Due Diligence në zinxhirin e furnizimit dhe komunikim të rregullt me investitorët dhe palët e interesit.

Përfundim

Zbatimi i këtyre masave do të përmirësonte ndjeshëm qeverisjen korporative të KosEnergy Infrastructure Group, do të rriste besueshmërinë ndaj investitorëve dhe institucioneve financiare, do të ulte rreziqet e agjencisë dhe do ta poziciononte kompaninë më mirë për procesin e listimit në bursë dhe realizimin e objektivave të strategjisë Vision 2030.

Problemi 2.

Menaxhimi Strategjik i Rrezikut dhe Kontrolli i Brendshëm

Raporti i Auditimit të Brendshëm i paraqitur Bordit të Drejtorëve identifikoi rreziqet e mëposhtme strategjike dhe operationale:

- Implementimi i sistemit ERP është realizuar vetëm në fabrikat në Kosovë, ndërsa fabrika në Shqipëri vazhdon të përdorë një sistem të pavarur informatik.
- Nuk ekziston një regjistër formal i rreziqeve (Enterprise Risk Register), ndërsa përgjegjësitë për menaxhimin e rrezikut nuk janë të përcaktuara.
- Sulmet kibernetike ndaj kompanive energjetike në Evropë janë rritur ndjeshëm gjatë dy viteve të fundit, por kompania nuk ka zhvilluar një plan formal të reagimit ndaj incidenteve (Cyber Incident Response Plan).
- Vonesat në furnizimin me bakër dhe komponentë elektronikë nga Azia kanë shkaktuar ndërprerje të prodhimit dhe vonesa në realizimin e kontratave.
- Rritja e çmimit të energjisë elektrike dhe e normave të interesit ka ndikuar negativisht në profitabilitetin e kompanisë.
- Nuk ekziston një politikë e përcaktuar për Risk Appetite dhe Risk Tolerance, ndërsa vendimet për pranimin e rreziqeve merren kryesisht nga CEO.
- Auditimi i Brendshëm raporton drejtpërdrejt te CFO dhe nuk ka qasje të drejtpërdrejtë në Komitetin e Auditimit apo në Bord.
- Kompania nuk kryen stress testing apo scenario analysis për projektet strategjike.

Kërkohet

1. Duke përdorur COSO Enterprise Risk Management Framework, analizoni sistemin aktual të menaxhimit të rrezikut në KosEnergy Infrastructure Group.

Identifikoni dobësitë kryesore dhe rekomandoni përmirësimet e nevojshme për secilin komponent të modelit COSO ERM.

(8 pikë)

2. Identifikoni gjashtë rreziqe strategjike me të cilat përballlet kompania.

Për secilin rrezik:

- klasifikojeni sipas kategorisë së rrezikut;
- vlerësoni ndikimin dhe probabilitetin;
- rekomandoni strategjinë më të përshtatshme të trajtimit të rrezikut.

(6 pikë)

3. Shpjegoni modelin Three Lines Model të Institutit të Auditorëve të Brendshëm (IIA).

Duke u bazuar në strukturën aktuale të kompanisë, analizoni nëse rolet dhe përgjegjësitë janë të ndara në mënyrë të përshtatshme dhe propozoni ndryshimet e nevojshme.

(6 pikë)

Totali: 20 pikë

Zgjidhja e Problemit 2

1. Duke përdorur COSO Enterprise Risk Management Framework, analizoni sistemin aktual të menaxhimit të rrezikut në KosEnergy Infrastructure Group. Identifikoni dobësitë kryesore dhe rekomandoni përmirësimet e nevojshme për secilin komponent të modelit COSO ERM. (8 pikë)

COSO Enterprise Risk Management Framework

COSO Enterprise Risk Management (ERM) është një kornizë ndërkombëtare për identifikimin, vlerësimin, menaxhimin dhe monitorimin e rreziqeve që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave strategjike të organizatës. Qëllimi i COSO ERM është të integrojë menaxhimin e rrezikut në procesin e planifikimit strategjik dhe vendimmarrjes.

Modeli COSO ERM përbëhet nga pesë komponentë kryesorë:

a) Governance and Culture

Ky komponent përcakton mënyrën se si Bordi dhe menaxhmenti krijojnë kulturën e menaxhimit të rrezikut dhe ndajnë përgjegjësitë.

Dobësitë në rast:

- Nuk ekziston Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut.
- Risk Appetite dhe Risk Tolerance nuk janë të përcaktuara.
- Vendimet për pranimin e rrezikut merren kryesisht nga CEO.
- Auditimi i Brendshëm raporton te CFO dhe jo te Komiteti i Auditimit.

Rekomandime

- Formimi i Komitetit të Menaxhimit të Rrezikut.
- Miratimi nga Bordi i Risk Appetite Statement.
- Ndarja e përgjegjësisë ndërmjet Bordit dhe menaxhmentit.
- Auditimi i Brendshëm duhet të raportojë funksionalisht te Komiteti i Auditimit.

b) Strategy and Objective Setting

Ky komponent siguron që rreziqet të merren parasysh gjatë formulimit të strategjisë.

Dobësitë në rast

- Strategjia "Vision 2030" nuk mbështetet nga një analizë formale e rreziqeve.
- Nuk ekziston Enterprise Risk Register.
- Nuk kryhen Scenario Analysis dhe Stress Testing.

Rekomandime

- Integrimi i ERM në procesin e planifikimit strategjik.
 - Hartimi i Enterprise Risk Register.
 - Kryerja e analizave të skenarëve dhe stress testing për projektet strategjike.
-

c) Performance

Ky komponent fokusohet në identifikimin, analizimin dhe trajtimin e rreziqeve.

Dobësitë në rast

- Rreziqet kibernetike nuk raportohen në Bord.
- Nuk ekziston Cyber Incident Response Plan.
- Nuk ka proces formal të monitorimit të rreziqeve.

Rekomandime

- Vlerësim periodik i rreziqeve.
 - Raportim i rregullt në Bord.
 - Zhvillimi i një Cyber Security Framework.
 - Përgatitja e një Incident Response Plan.
-

d) Review and Revision

Ky komponent siguron që sistemi i menaxhimit të rrezikut të përmirësohet vazhdimisht.

Dobësitë në rast

- Nuk kryhen rishikime periodike të sistemit ERM.

- Mungon monitorimi sistematik i ndryshimeve në mjedisin e biznesit.

Rekomandime

- Rishikim vjetor i Risk Register.
- Auditime periodike të sistemit ERM.
- Raportim periodik në Bord mbi ekspozimin ndaj rrezikut.

e) Information, Communication and Reporting

Ky komponent siguron që informacioni mbi rrezikun të komunikohet në kohë dhe në mënyrë efektive.

Dobësitë në rast

- ERP nuk është i integruar ndërmjet fabrikave.
- Fabrika në Shqipëri përdor sistem të ndryshëm informatik.
- Informacioni mbi rrezikun nuk shpërndahet në mënyrë të centralizuar.

Rekomandime

- Integrimi i plotë i ERP në të gjitha njësitë.
- Krijimi i dashboard-eve për raportimin e rrezikut.
- Raportim periodik i rreziqeve strategjike tek Bordi.

Përfundim

Nga analiza sipas COSO ERM rezulton se KosEnergy Infrastructure Group nuk ka një sistem të integruar të menaxhimit të rrezikut. Dobësitë ekzistojnë në të gjithë komponentët e modelit dhe kërkojnë përmirësime të konsiderueshme për të mbështetur realizimin e strategjisë "Vision 2030" dhe procesin e listimit në bursë.

2. Identifikoni gjashtë rreziqe strategjike me të cilat përballet kompania. Për secilin rrezik: klasifikojeni sipas kategorisë së rrezikut; vlerësoni ndikimin dhe probabilitetin; rekomandoni strategjinë më të përshtatshme të trajtimit të rrezikut. (6 pikë)

Rreziku	Kategoria	Probabiliteti Ndikimi		Trajtimi
Implementimi jo i plotë i ERP	Operacional / Teknologjik	I lartë	I lartë	Integrimi i ERP në të gjitha fabrikat dhe standardizimi i proceseve.
Sulmet kibernetike	Teknologjik / Operacional	I lartë	Shumë i lartë	Implementimi i Cyber Security Framework, Incident Response Plan dhe testime periodike.
Vonesat në furnizim nga Azia	Strategjik / Operacional	Mesatar	I lartë	Diversifikimi i furnitorëve, kontrata afatgjata dhe krijimi i stokut strategjik.
Rritja e çmimeve të energjisë dhe normave të interesit	Financiar	I lartë	I lartë	Hedging, investime në efikasitet energjetike dhe optimizim i strukturës së financimit.
Mungesa e politikës së Risk Appetite	Qeverisje	Mesatar	I lartë	Hartimi dhe miratimi nga Bordi i Risk Appetite Statement dhe Risk Tolerance.
Mungesa e raportimit ESG dhe Due Diligence	Pajtueshmëri / Reputacional	Mesatar	Shumë i lartë	Zhvillimi i politikave ESG, Due Diligence dhe raportimi sipas ESRS.

Përfundim

Rreziqet me ndikimin më të madh janë rreziqet kibernetike, rreziqet e furnizimit dhe mungesa e strukturës së qeverisjes së rrezikut. Këto mund të ndikojnë drejtpërdrejt në realizimin e strategjisë "Vision 2030" dhe në aftësinë e kompanisë për të siguruar financim dhe për t'u listuar në bursë.

3. Shpjegoni modelin Three Lines Model të Institutit të Auditorëve të Brendshëm (IIA). Duke u bazuar në strukturën aktuale të kompanisë, analizoni nëse rolet dhe përgjegjësitë janë të ndara në mënyrë të përshtatshme dhe propozoni ndryshimet e nevojshme. (6 pikë)

Three Lines Model

Modeli Three Lines Model i Institutit të Auditorëve të Brendshëm (IIA) është një model i qeverisjes që përcakton përgjegjësitë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e rrezikut.

Linja e Parë – Menaxhmenti Operativ

Linja e parë përbëhet nga menaxherët operativë, të cilët janë përgjegjës për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve në aktivitetet e tyre të përditshme.

Në rastin e KosEnergy Infrastructure Group, menaxhmenti duhet të jetë përgjegjës për kontrollin e proceseve të prodhimit, furnizimit, IT-së dhe financave.

Linja e Dytë – Funksionet e Mbikëqyrjes

Linja e dytë përfshin funksionet që monitorojnë dhe mbështesin menaxhimin e rrezikut, si:

- Risk Management;
- Compliance;
- ESG;
- Siguria e Informacionit.

Në rastin konkret, kjo linjë nuk është e zhvilluar. Kompania nuk ka Komitet të Menaxhimit të Rrezikut, nuk ka Enterprise Risk Register dhe nuk ka politika të qarta për Risk Appetite.

Linja e Tretë – Auditimi i Brendshëm

Auditimi i Brendshëm duhet të japë siguri të pavarur mbi efektivitetin e qeverisjes, kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të rrezikut.

Në rastin e KosEnergy Infrastructure Group, Auditimi i Brendshëm raporton drejtpërdrejt te CFO, gjë që cenon pavarësinë e tij. Sipas praktikave ndërkombëtare, Auditimi i Brendshëm duhet të raportojë funksionalisht te Komiteti i Auditimit dhe administrativisht te CEO.

Analiza e strukturës aktuale

Struktura aktuale nuk siguron ndarje të qartë të roleve dhe përgjegjësie.

Dobësitë kryesore janë:

- mungesa e funksionit formal të menaxhimit të rrezikut;
- mungesa e Komitetit të Riskut;
- raportimi jo i pavarur i Auditimit të Brendshëm;
- mungesa e koordinimit ndërmjet linjës së parë, të dytë dhe të tretë.

Rekomandime

Për të përmirësuar sistemin e qeverisjes dhe kontrollit të brendshëm, kompania duhet të:

- krijojë funksionin formal të Enterprise Risk Management;
- themelojë Komitetin e Menaxhimit të Rrezikut;
- sigurojë që Auditimi i Brendshëm të raportojë funksionalisht te Komiteti i Auditimit;
- përcaktojë qartë përgjegjësitë e secilës linjë sipas Three Lines Model;
- zhvillojë mekanizma efektivë të komunikimit ndërmjet menaxhmentit, funksioneve të mbikëqyrjes dhe Auditimit të Brendshëm.

Përfundim

Zbatimi i Three Lines Model do të forconte ndjeshëm qeverisjen, kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin e rrezikut në KosEnergy Infrastructure Group, duke rritur besueshmërinë ndaj investitorëve dhe institucioneve financiare dhe duke mbështetur objektivat strategjike të kompanisë.

Problemi 3.

Pas analizimit të pasqyrave financiare të KosEnergy Infrastructure Group, Bordi kërkon të vlerësojë stabilitetin financiar të kompanisë para se të vazhdojë me strategjinë "Vision 2030" dhe me procesin e listimit në bursë.

Kërkohet

i)

Gjeni koeficientët financiarë si më poshtë dhe shpjegoni rëndësinë e secilit koeficient në vlerësimin e rrezikut të biznesit, si dhe ndikimin e tij tek palët e interesit.

- a) Koeficienti i borxhit (3 pikë)
- b) Leverazhi financiar (3 pikë)
- c) Mbulesa e interesit (3 pikë)
- d) Koeficienti i rrjedhës së parasë (3 pikë)
- e) Koeficienti qarkullues (3 pikë)
- f) Koeficienti i shpejtësisë (Acid Test Ratio) (3 pikë)

(Totali 18 pikë)

(Në shtojcë do të vendosen Pasqyra e Pozicionit Financiar, Pasqyra e të Ardhurave dhe Pasqyra e Rrjedhës së Parasë.)

ii)

Zhvillimi Moral Kognitiv i Kohlberg dhe Modeli me Pesë Pyetje i Tucker

Teoria e zhvillimit moral kognitiv e Lawrence Kohlberg shpjegon mënyrën se si individët evoluojnë në procesin e marrjes së vendimeve etike.

Modeli me pesë pyetje i Tucker ofron një kornizë praktike për vlerësimin e vendimeve korporative nga aspekti etik.

Duke përdorur këto dy modele:

- analizoni vendimet kryesore të marra nga menaxhmenti i KosEnergy Infrastructure Group;
- ndërtoni matricën e Tucker;

- identifikoni nivelin e zhvillimit moral sipas Kohlberg për secilin vendim;
- diskutoni ndikimin që këto vendime kanë mbi palët kryesore të interesit.

(12 pikë)

Totali Problemi 3: 30 pikë

Zgjidhja e Problemit 3

i) Llogaritni koeficientët financiarë dhe shpjegoni rëndësinë e secilit në vlerësimin e rrezikut të biznesit dhe ndikimin tek palët e interesit.

a) Koeficienti i Borxhit (Debt Ratio) (3 pikë)

Formula

$$\text{Debt Ratio} = \frac{\text{Detyrimet Totale}}{\text{Asetet Totale}}$$

Llogaritja

$$= \frac{72,500}{117,500} = 0.617$$

ose

$$61.7\%$$

Interpretimi

61.7% e aktiveve financohen nga kapitali i huaj, ndërsa vetëm 38.3% financohen nga kapitali vetanak.

Ky nivel konsiderohet relativisht i lartë për një kompani prodhuese, duke treguar ekspozim të konsiderueshëm ndaj rrezikut financiar.

Ndikimi tek palët e interesit

- Bankat – rrezik më i madh kreditor.
 - Investitorët – rritet rreziku financiar, por mund të rritet edhe kthimi mbi kapital nëse investimet janë fitimprurëse.
 - Aksionarët – ekspozohen ndaj rrezikut më të madh në rast rënieje të fitimeve.
 - Kreditorët – monitorojnë aftësinë e kompanisë për të shlyer detyrimet.
-

b) Leverazhi Financiar (Financial Leverage) (3 pikë)

Formula

$$\text{Leverage} = \frac{\text{Detyrimet Totale}}{\text{Kapitali}}$$

Llogaritja

$$=72,500/45,000=1.61=\frac{72,500}{45,000}=1.61=45,000/72,500=1.61$$

Interpretimi

Për çdo 1 euro kapital të aksionarëve, kompania përdor 1.61 euro financim nga borxhi.

Një leverazh i tillë rrit potencialin për kthime më të larta, por njëkohësisht rrit ndjeshëm rrezikun financiar, veçanërisht në periudha të rritjes së normave të interesit.

Ndikimi tek palët e interesit

- Aksionarët mund të përfitojnë nga kthime më të larta nëse kompania është fitimprurëse.
- Kreditorët ekspozohen ndaj rrezikut më të madh të mospagesës.
- Investitorët institucionalë mund ta konsiderojnë kompaninë më të rrezikshme.

c) Koeficienti i Mbulesës së Interesit (Interest Coverage Ratio) (3 pikë)

Formula

$$\text{Interest Coverage} = \frac{\text{EBIT}}{\text{Shpenzimet e Interesit}} \\ \text{Interest Coverage} = \frac{\text{Shpenzimet e Interesit}}{\text{EBIT}}$$

Llogaritja

$$=15,100/3,400=4.44=\frac{15,100}{3,400}=4.44=3,400/15,100=4.44$$

Interpretimi

Fitimi operativ mbulon shpenzimet e interesit rreth 4.4 herë.

Ky rezultat tregon se kompania aktualisht është në gjendje të përmbushë detyrimet për interes, megjithëse rritja e normave të interesit mund të ulë këtë tregues.

Ndikimi tek palët e interesit

- Bankat e konsiderojnë këtë raport një tregues kyç të aftësisë paguese.
- Investitorët fitojnë siguri për stabilitetin financiar.
- Menaxhmenti duhet të monitorojë vazhdimisht ndikimin e borxhit në fitim.

d) Koeficienti i Rrjedhës së Parasë (Operating Cash Flow Ratio) (3 pikë)

Formula

$$\text{Cash Flow Ratio} = \frac{\text{Fluksi Operativ}}{\text{Detyrimet Afatshkurtra}}$$
$$\text{Cash Flow Ratio} = \frac{13,800}{30,500} = 0.45$$

Llogaritja

$$= \frac{13,800}{30,500} = 0.45$$

Interpretimi

Fluksi operativ mbulon vetëm 45% të detyrimeve afatshkurtra.

Ky rezultat tregon se kompania nuk gjeneron mjaftueshëm para nga aktiviteti operativ për të mbuluar plotësisht detyrimet afatshkurtra dhe mund të ketë nevojë për financim shtesë.

Ndikimi tek palët e interesit

- Kreditorët shqetësohen për likuiditetin.
- Bankat mund të kërkojnë kolateral shtesë.
- Menaxhmenti duhet të përmirësojë menaxhimin e kapitalit qarkullues.

e) Koeficienti Qarkullues (Current Ratio) (3 pikë)

Formula

$$\text{Current Ratio} = \frac{\text{Aktivet Qarkulluese}}{\text{Detyrimet Afatshkurtra}}$$
$$\text{Current Ratio} = \frac{36,500}{30,500} = 1.20$$

Llogaritja

$$= \frac{36,500}{30,500} = 1.20$$

Interpretimi

Kompania ka 1.20 euro aktive qarkulluese për çdo 1 euro detyrim afatshkurtër.

Ky raport tregon se kompania është në gjendje të përmbushë detyrimet afatshkurtra, por niveli i likuiditetit nuk është shumë komod për një industri prodhuese.

Ndikimi tek palët e interesit

- Kreditorët e konsiderojnë raportin të pranueshëm.
 - Furnitorët fitojnë më shumë besim për pagesat.
 - Menaxhmenti duhet të monitorojë inventarin dhe arkëtimet.
-

f) Koeficienti i Shpejtësisë (Acid Test Ratio) (3 pikë)

Formula

$$\text{Quick Ratio} = \frac{\text{Aktivet Qarkulluese} - \text{Inventari}}{\text{Detyrimet Afatshkurtra}}$$
$$\text{Quick Ratio} = \frac{36,500 - 16,200}{20,300} = 0.67$$

Llogaritja

$$= \frac{36,500 - 16,200}{20,300} = 0.67$$

Interpretimi

Pa përfshirë inventarin, kompania disponon vetëm 0.67 euro aktive likuide për çdo 1 euro detyrim afatshkurtër.

Ky raport tregon se kompania varet në masë të konsiderueshme nga shitja e inventarit për të përmbushur detyrimet afatshkurtra.

Ndikimi tek palët e interesit

- Bankat mund ta konsiderojnë këtë si sinjal të dobësisë së likuiditetit.
 - Investitorët mund të kërkojnë përmirësim të menaxhimit të kapitalit qarkullues.
 - Menaxhmenti duhet të përshpejtojë arkëtimin e llogarive të arkëtueshme dhe të optimizojë nivelin e inventarit.
-

Përfundim i përgjithshëm i analizës financiare

Analiza e koeficientëve tregon se KosEnergy Infrastructure Group është një kompani fitimprurëse me aftësi të kënaqshme për të mbuluar interesin dhe detyrimet afatshkurtra nëpërmjet aktiveve qarkulluese. Megjithatë, kompania ka një nivel relativisht të lartë të borxhit dhe likuiditet të kufizuar kur përjashtohet inventari.

Përpara realizimit të strategjisë "Vision 2030" dhe procesit të listimit në bursë, Bordi duhet të fokusohet në uljen e leverazhit financiar, përmirësimin e fluksit operativ të parasë dhe forcimin e pozitës së likuiditetit.

